



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 510, datë 25.10.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL,
VITI KALENDARIK 2019, PËR GJYQTAREN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.10.2021, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin e përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale lidhur me ecurinë e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar viti kalendarik 2019 për gjyqtaren {...}, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të kësaj procedure vlerësimi ;

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 330, datë 17.09.2020, ka vendosur verifikimin e plotësisimit të tre kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë për gjyqtaren {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87, datë 26.02.2020.

Pas marrjes së këtij vendimi, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me vendimin nr. 337, datë 24.09.2020, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë..

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

...6. Për gjyqtaren znj. {...} – relator znj. Brikena Ukperaj – nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha”.

Në vijim ka filluar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit, duke u kryer veprimet si më poshtë:

- Në datë 25.09.2020, në bazë të neneve 85 pika 2 dhe 89 pika 3 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të Vendimit të KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit janar–dhjetor 2019 (vlerësimi i përshpejtuar i detyruar), për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtari të Këshillit.
- Në datë 30.09.2020, gjyqtarja {...} ka konfirmuar marrjen e njoftimit nëpërmjet postës elektronike, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit, si dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre ose të ndonjë anëtari të Këshillit.
- Në datën 06.10.2020, gjyqtarja {...} i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, njoftim i cili i është dërguar edhe kryetarit të gjykatës. Me shkresën nr. 2895/4 prot., datë 06.11.2020, protokolluar në KLGJ me nr. 2895/4 prot., datë 06.11.2020, është dërguar “Formular i integruar i vlerësimit të gjyqtarit”.
- Në datë 30.09.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 4772 prot., Shkollës së Magjistraturës i është kërkuar informacion lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarës {...} në veprimtaritë trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit, viti kalendarik 2019 (01.01.2019-31.12.2019). Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 791/1 prot., datë 12.10.2020.
- Në datë 30.09.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 4772/1 prot., Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar informacion lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës {...} gjatë periudhës së vlerësimit, viti kalendarik 2019 (01.01.2019-31.12.2019). Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 08.10.2020 ka dërguar në rrugë elektronike të dhënat për ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës.

Ndërkohë që procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar ka qenë duke u zhvilluar, Këshilli me vendimin nr.246, datë 14.07.2021, ka vendosur: *1. Shfuqizimin e vendimit nr. 330, datë 17.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87 datë 26.02.2020 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. 2. Skualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr.155/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të këshillit të Lartë gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 4. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar”.*

Kundër vendimit nr. 246, datë 14.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} ka ushtruar të drejtën e ankimit duke iu drejtuar është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padinë me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. 246, datë 09.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të pezulluar procesin e kandidimit të paditëses për emërimin/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, deri në datën e marrjes së vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit mbi ankimin e ushtruar nga paditësja ndaj vendimit nr. 350, datë 23.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.”.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 62 (86-2021-545), datë 20.09.2021¹ ka vendosur: *“1. Rrëzimin e padisë. 2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. 3. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar”.*

Për sa më sipër vendimi nr.246, datë 09.06.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka marrë formë të prerë.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Neni 97, pika 1 e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: *“1. Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.”*

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në nenin 22 pika 1 të së cilit parashikohet se: *“1. Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarit.”*

Neni 97 pika 3 i Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikon : *”Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.”.*

Ndërkohë në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se : *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.*

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar etik dhe profesional të gjyqtarës {...} ka filluar me vendimin nr. 337, datë 24.09.2020, pas verifikimit të plotësisht të tre kushteve ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit. Kjo procedurë vlerësimi bazohet në vendimin e KLGJ-së nr. 263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, në nenin 22 pika 1 të së cilit, janë përcaktuar rregulla të posaçme për

¹ Vendimi i arsyetuar i është dërguar në KLGJ në datë 18.10.2021, me nr. 3016/6 prot.

vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare.² Këto rregulla parashikojnë detyrimin e Këshillit që, në çdo rast ngritjeje në detyrë apo lëvizjeje paralele, të bëjë vlerësim të përshpejtuar, pa kërkesë të gjyqtarit, duke respektuar rregullat e vlerësimit të përshpejtuar me afate të përgjysmuara. Zhvillimi i kësaj procedure, e cila iniciohet pas kërkesës së gjyqtarit për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë dhe kualifikimit të tij për plotësim të kriterëve ligjore, synon të garantojë zhvillimin e një procesi të shpejtë, efektiv dhe të njëjtë vlerësimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, për të siguruar të paktën 1 (një) vlerësim profesional në kohë, të njëjtë dhe real me atë të kërkesës së gjyqtarit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele.

Gjatë ecurisë së procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli me vendimin nr.246, datë 09.06.2021, ka shfuqizuar vendimin e verifikimit të 3 kriterëve të kandidimit për Gjykatën e Lartë për znj. {...}, duke e përjashtuar atë nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë për të vetmin pozicion të kandiduar prej saj, të shpallur me vendimin Nr. 87 dt. 26.02.2020. Kjo rrethanë afekton vijueshmërinë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për këtë gjyqtare, pasi pas skualifikimit të gjyqtares dhe përjashtimit të saj nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, qëllimi për të cilin ka nisur kjo procedurë vlerësimi nuk ekziston më. Gjyqtarja kishte kandiduar vetëm për një nga pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, pozicionin Nr. 87 datë 26.02.2020, pozicion për të cilin edhe procedura e ngritjes në detyrë ka përfunduar gjithashtu me emërimin në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të gjyqtarit z. Astrit Kalaja.

Bërja e pamundur e objektit apo qëllimit të një procedure administrative përbën shkak për deklarimin e përfunduar të saj pa një vendim përfundimtar. Në ligjin nr. 96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, neni 95 i të cilit parashikon rastet se kur një procedurë administrative e filluar deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar.

Në rastin konkret, skualifikimi dhe përjashtimi i gjyqtares nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë si dhe përfundimi i kësaj procedure për të vetmin pozicion për të cilin gjyqtarja ka kandiduar, nëpërmjet emërimit të një gjyqtari tjetër në Gjykatën e Lartë, janë rrethana që sjellin rënie të shkakut për të cilën ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për znj. {...}. Për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi që ka ekzistuar në fillim të këtij procesi nuk ekziston më, që në gjuhën e ligjit parashikohet si “*qëllim i bërë i pamundur*”. Vërtetimi i kësaj rrethane të fundit sjell si pasojë përfundimin e procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar. Ndërkohë viti kalendarik 2019 për të cilin kishte filluar kjo procedurë vlerësimi për gjyqtaren znj. {...}, do të përfshihet në periudhën 5 vjeçare të vlerësimit në të cilën bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të Ligjit për Statusin.

² Në lidhje me periudhën kalimtare gjatë se cilës zbatohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar, në pikën 1 të nenit 25 parashikohet si periudhë kalimtare periudha kohore deri në miratimin nga Këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve dhe realizimit të procedurave të vlerësimit, sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve

IV. VLERËSIMI NGA KËSHILLI

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për gjyqtaren {...}, e filluar me vendimin nr. 337, datë 24.09.2020, duhet të përfundojë pa vendim përfundimtar, për shkak se qëllimi për të cilin ajo ka filluar është bërë i pamundur.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor;

V E N D O S I:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}, për shkak se qëllimi i kësaj procedure është bërë i pamundur.
2. Viti kalendarik 2019 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR